



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë **22.04.2024**, Nr. Regj.Them **61**, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt: Për gjykimin në themel të procedimit penal Nr.61, të vitit 2022, me të pandehur **Erjon Cëriku**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët **Erjon Bani, Flojera Davidhi dhe Erjon Çela**, me vendimin Nr. **45**, datë **10.07.2024**, vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Erjon Cëriku** për veprën penale të “*Korrupsion aktiv të gjyqtarit, prokurorit ose funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 319 e 25 i K.Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e tij me **1(një) vit burgim**.
2. Vuajtja e dënimit do të kryhet nga i pandehuri në një burg të sigurisë së zakonshme dhe do të fillojë nga momenti i ekzekutimit të këtij vendimi, pasi të marrë formë të prerë.
3. Provat materiale të bashkëlidhur me fashikullin e gjykimit **6(gjashtë) CD në total**, ku 1(një) CD me pamjet filmike të emisionit investigativ STOP në TV Klan, të marra nga rrjeti social Youtubee, 3(tre) CD me pamjet e plota filmike të vëna në dispozicion nga TV Klan, që lidhen me emisionin STOP, dhe 2 (dy) CD me përmbajtjen e të dhënave të përfituara nga akti ekspertimit të telefonit të të pandehurit Nazmi Totraku, të mbeten pjesë e fashikullit të gjykimit.
4. Shpenzimet proceduriale të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore t’i ngarkohen të pandehurit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë më datë **10.07.2024**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar